



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:280090
Datë: 05.02.2025
Numri i dokumentit: 06806326

PAKR.nr.614/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari, kryetar i kolegjit, Valbona Musliu Selimaj dhe Kymete Kicaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Jeta Asllani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. K., i akuzuar për shkak të veprave penale, Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 pika 1.8 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Sh. K., Av. Florent Latifaj, të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.671/22, të datës 23.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Sh. K., av. Florent Latifaj dhe sipas detyrës zyrtare, ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.671/22, të dt.23.08.2024, ashtu që çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e rivendosje.

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, tani për tani është jo lëndore.

Të akuzuarit Sh. K., i vazhdohet paraburgimi, pasi që ende ekzistojnë kushtet ligjore.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.671/22, të datës 23.08.2024, të akuzuarin Sh. K. e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje nga neni 172 lidhur me nenin 31 të KPRK-së të kryer në bashkëkryerje me të miturin A. K. dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për veprën penale të përshkruar si në dispozitivin e parë Vrasje nga neni 172 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të pandehurit Sh. K. i ka caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 19 vite e 6 muaj.

Për veprën penale të përshkruar si në dispozitivin e dytë, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK – së të pandehurit i ka caktuar dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Andaj Gjykata, në pajtim me nenin 76 të KPRK-së të pandehurit Sh. K. i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 20 vite, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të pandehurit në pajtim me nenin 79 të KPRK-së, koha e kaluar në paraburgim nga data 10.12.2021 i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim.

Të pandehurit i është vazhduar masa e paraburgimit nga data 25.07.2024, e deri sa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo më gjatë se koha e dënimit me burgim të shqiptuar në aktgjykim.

Është urdhëruar konfiskimi i një thike me gjatësi 6 cm, me mbishkrim “ LEATHERMAN Sidekick’ 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Është urdhëruar Policia e Kosovës të bëjë shkatërrimin e armës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë pasi të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

I pandehuri është obliguar që t’i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej dyqind (200) Euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro dhe pjesën tjetër sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar është udhëzuar që kërkesën pasurore juridike ta paraqet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Prishtinë për shkak të vendimit mbi dënimin. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që aprovojë ankesën e Prokurorisë si të bazuar dhe të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. K., Av. Florent Latifaj për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të aprovojë ankesën, të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të pandehurin ta lirojë nga akuza, ose të anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën të kthejë Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.557/24, të datës 23.10.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë, ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Sh. K., Av. Florent Latifaj.

Në kuptim të nenit 390 të KPPRK-së kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për datë 05.12.2024 dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar përfaqësuesi i palës së dëmtuar Faik Xhemshiti, i akuzuari Sh. K. dhe mbrojtësi i të akuzuarit Sh. K., Av. Florent Latifaj, ndërsa Prokurori i shtetit ndonëse i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantoi në seancë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar Faik Xhemshiti në seancën e kolegjit ka theksuar se konsideron se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënimin e merituar, andaj ka kërkuar që të akuzuarit Gjykata e Apelit t'i shqiptojë një dënim më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. K., Av. Florent Latifaj ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës së parashtruar për të gjitha bazat. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i drejtë, i njëjti nuk përputhet me provën kryesore të ekspertit të mjekësisë ligjore Arsim Gërxhaliut i cili ka potencuar se thika që i është konfiskuar të akuzuarit nuk ka qenë ajo që e ka shkakuar vdekjen. Ajo çka ka deklaruar i akuzuari e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët në deklaratimet e tyre se Shkumbini vetëm një herë e ka goditur tani të ndjerin në dorë. Po ashtu dispozitivi i aktgjyimit si në pikën I dhe II është kontradiktor dhe në kundërshtim me veten e tij. Gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur t'i vërtetojë faktet që e karakterizojnë veprën penale për të cilën është dënuar i akuzuari. Në

shqyrtimin fillestar pranë Gjykatës së shkallës së parë, pesë herë kam kërkuar që ndaj të akuzuarit të aplikohet Kodi për të Mitur, nga se i njëjti kur supozohet se e ka kryer veprën i ka pas 18 vjet e 3 muaj, çka do të thotë se ndaj kryerësve të veprave penale deri në moshën 21 vjeçare mund të aplikohet ky Kod, nuk e di pse Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar këtë kërkesë time ligjore. Sh. me tani të ndjerin ka ardhur në të njëjtin autobus, rrahjen e ka nis i ndjeri me vëllain e tij, ky nuk ka pasur dëshirë të ndodh ky rast, pra rasti ka ndodhur aty për aty. Kur është bërë rikonstruimi i vendit të ngjarjes nuk është marrë në pyetje i akuzuari dhe as një dëshmitarë, prandaj në bazë të cekurave ky aktgjykim assesi nuk mund të kaloj. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të njëjtin ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim apo nuk mungesë të provave të njëjtin ta lirojë nga akuza.

I akuzuari Sh. K. ka deklaruar se e përkrah në tërësi deklarin e mbrojtësit të tij, i vjen keq për rastin, nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është dënua me njëzet vite.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPRK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore në ankesë gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit është e bazuar, por duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i ankimuar duhet të anulohet, ngase ekzistojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij, ndërsa ankesa e prokurorisë tani për tani është jo lëndore.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të shtetit

Prokurori i shtetit në ankesë konsideron se në aktgjykimin e ankimuar është vërtetuar drejt dhe saktë gjendja faktike, aktgjykimi nuk përmban shkelje esenciale dhe nuk ka shkelje të ligjit penal, andaj ankesa është parashtruar vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Sipas prokurorit, Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejt dhe në masë të duhur rrethanat rënduese të paraqitura dhe arsyetuara nga Prokuroria në fjalën e saj përfundimtare. Sa i përket rrethanave të pavlerësuar nga Gjykata e shkallës së parë e të pretenduara nga Prokuroria, përkatësisht ato nga neni 70 par 2 pika 2.3 e KPRK-së nga prezenca e dhunës dhe kanosjes në kryerjen e veprës penale në veprimet e të akuzuarit, vërtetohet edhe shkalla e lartë e dashjes në shkaktimin e pasojës. Sepse i akuzuari Sh. kishte mundësi të evitonte mosmarrëveshjen mes vëllait tij të mitur dhe të ndjerit V. por në vend të kësaj ai me dashje dhe vetëdije kishte zgjedhur t'i bashkëngjitet sulmit të kundërligjshëm dhe me mjet të mprehtë ta

godet tani të ndjerin duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse e duke e lënë pa ofrim të ndonjë ndihme por duke u kujdesur që të largohet nga vendi i ngjarjes dhe t'i fsheh provat (mjetet) e kryerjes se veprës me çka tregon edhe për sjelljen e tij pas veprës qoftë ne raport me pasojën e shkaktuar, qoftë me provat e veprës penale, pastaj pika 2.4, mënyra mizore e kryerjes së veprës penale pasi që i akuzuari veprimet e tij inkriminuese i ka ndërmarr në mënyrë mizore, të vrazhdë ndaj viktimës së pambrojtur dhe se pas veprimit inkriminues është larguar duke fshehur mjetin (thikën) me te cilën ka kryer veprën, pika 2.7, mosha e viktimës, duke marr parasysh se i ndjeri në kohën e vrasjes ka qenë i moshës së re, si dhe pika 2.8 ,shkalla e dëmit të shkaktuar, duke vlerësuar faktin se me veprimet e tij i akuzuari ka shkaktuar pasojën e trajtës më të rëndëvdekjen e viktimës duke shkaktuar dëm të përhershëm dhe te pariparueshëm edhe ndaj familjes së palës së dëmtuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit Sh. K., Av. Florent Latifaj

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje të nenit 384 par 1 pika 1.10 lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 si dhe neni 384 par. 2 pika 2.5 e KPP-si, ngase nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyeje i ka konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara, aktgjykimi është tërësisht i përzier nuk ka arsyetim te pikave për të cilat i njëjti gjendet fajtor, por mjaftohet vetëm me shprehjen bashkëkryerje kështu duke mos i individualizuar veprimet me të miturin të cilin e konsideron gjykata si bashkëkryes. Po ashtu arsyetimi i aktgjykimit nuk përputhet me provën kryesore - mendimin e ekspertit mjekoligjor Dr. Arsim Gërxhaliu. Eksperti gjatë shqyrtimit të mbajtur në çështjen penale PM.nr.29/22, kundër të miturit A. K., ka deklaruar se plagët e shkaktuara në krah dhe parakrah, janë shkaktuar nga mjete që posedon dy tehe dhe nuk kanë qenë plagë nga të cilat është shkaktuar vdekja, e kjo për faktin se mjete i konfiskuar nga Sh. K. është në formë të danave që rrjedhimisht len të kuptohet se me veprimin e të akuzuarit nuk ka ardhur deri tek vdekja e viktimës dhe sipas konstatimit të mjekut thika e marr nga i akuzuari nuk i ka shkaktuar asnjë plagë të ndjerit këtë e konstaton mjeku-eksperti i mjekësisë ligjore me mendimin e tij të cilin e ka dhënë pas rikonstruksionit të vendit të ngjarjes. Se mjete (thika) e konfiskuar nga i akuzuari nuk është përdorur me rastin e goditjes së të ndjerit këtë gjendje e ka paraqit edhe gjykata në aktgjykimin e saj në faqe 11 par. 2-të ku në rreshtin e dytë dhe të tretë konstaton se brisku-thika e gjetur tek i pandehuri Sh. K. nuk është ajo që i ka shkaktuar plagë të ndjerit. Gjykata në aktgjykimin e saj në faqen e 21 në paragrafin e fundit bën pyetje se “pasi që thika e konfiskuar nga i pandehuri Sh.

nuk qenka ajo që i ka shkaktuar plagë të ndjerit atëherë logjikshëm shtrohet pyetja me çka e ka goditur i pandehuri viktimën kur vet e pranon faktin se njëherë e ka goditur me thikë viktimën dhe vazhdon se i pandehuri ka mundur me përdor një thike tjetër dhe si mundësi për ti ikur përgjegjësisë penale e ka prezantuar këtë thikë si mjet që e ka poseduar në natën kritike...". Këto konstatime jo vetëm që nuk kanë mbështetje në ekspertizën mjekoligjore, e as në deklaratimet e dëshmitarëve apo të vet të pandehurit, këto konstatime nuk kanë as kuptim logjik.

Për më tepër, dëshmitari okular M. H. ka deklaruar se e ka parë Sh. kur e ka goditur të ndjerin njëherë në pjesën e majtë të kraharorit, njëjtë ka deklaruar edhe i akuzuari, e kjo përputhet në tërësi edhe me konstatimin e ekspertit se nga thika e Sh. K. të ndjerit nuk i është shkaktuar asnjë pasojë.

Sipas mbrojtjes, Gjykata Themelore, Departamenti i Krimeve të Rënda në seancën fillestare me datë 16.01.2023 ka aprovuar pranimin e fajësisë për të akuzuarin sa i përket veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 366 par. 1 të KPRK-së. Gjykata e shkallës së parë në faqe 25 paragrafi i tretë ka konstatuar se ka bërë ndryshimin e përshkrimit faktik duke fshirë pjesën e dispozitivit ku thuhet me të cilën thikë i pandehuri kreu vrasjen. Gjykata nuk mundet që të ndryshoj përshkrimet faktike të cilat i ka aprovuar njëherë ngase i akuzuari ka pranuar atë gjendje se atë armë e ka përdorur siç është përshkruar në dispozitivin e parë e jo ndonjë armë tjetër, të cilën tash ja mvesh gjykata në aktgjykim.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë edhe në vend të ngjarjes nuk i ka ftuar të gjithë dëshmitarët okular, nuk e ka pyetur të pandehurin në vend të ngjarjes lidhur me paraqitjen e ngjarjes nga ana e tij për të vërtetuar faktet e rëndësishme për zbardhjen e ngjarjes ashtu siç e parashohin edhe dispozitat e KPP-së.

Lidhur me shkeljen e ligjit penal, mbrojtja pretendon se ngase i akuzuari është shpallur fajtor për një vepër të cilën nuk e ka kryer, është shkelur ligji penal në dëm të tij. Gjykata e shkallës së parë në tërësi ka dështuar të paraqes veprimet e të akuzuarit në rastin konkret dhe duke bazuar në gjithçka që do të duhej të interpretohej në favor të të pandehurit. Gjykata të gjitha ato fakte duke filluar nga konstatimi i ekspertit mjeko ligjor ku ai nuk e përjashton mundësin e përdorimit të dy thikave, ndërsa gjykata thotë pra nuk përjashtohet mundësia që të jenë përdorur e jo që janë përdorur, edhe këtë e interpreton në disfavor të të pandehurit duke thënë se mos përjashtimi nënkupton se janë përdorur. Pastaj vazhdon me konstatimin se vet e ka pranuar se e ka goditur në dorë një herë, njëjtë thotë edhe dëshmitari M. H. se i pandehuri e ka goditur në dorë njëherë

të ndjerin. Gjykata këto fakte i paraqet se ja ku u vërtetua vrasja me goditje në dore mbi rroba në kohë dimri me datë 10.12.2012, në mbrëmje ora 21.25, andaj nga provat dhe dëshmitë e dëshmitarëve është e qartë se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale sipas dispozitivit të parë, e që ligji penal është shkelur në disfavor të të njëjtit.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë e ka bazuar vendimin në dëshmitë e dëshmitarëve, provat materiale dhe ekspertizën e ekspertit mjeko ligjor dhe konstaton gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Si është e mundur që gjykata e merr si të vërtetuar gjendjen e paraqitur nga K. P. dhe thotë se i njëjti e ka parë ngjarjen kur ai vet thotë se është rrëzuar në tokë. Ndërsa dëshmitarëve okular G. S. dhe M. H. nuk ua fal besimin edhe pse të njëjtit në tërësi e kanë parë ngjarjen, deklaratimet e tyre përputhen me deklaratimet dhe konstatimet e ekspertit dhe të pandehurit Sh.. Kjo ngase i akuzuari Sh. edhe në prokurori edhe në gjykatë ka deklaruar se e ka goditur vetëm një herë në dorën e majtë të ndjerin. Të njëjtën gjë e ka deklaruar edhe dëshmitari M. ku thotë se e ka parë vetëm njëherë që e ka goditur në krah tani të ndjerin gjë e cila vërtetohet edhe me ekspertizën e cila thotë se me thikën që iu është gjetur dhe konfiskuar nga i pandehuri nuk është goditur i ndjeri. Dëshmitari K. i cili është daja i të ndjerit thotë se nuk ka parë asnjëherë duke u goditur me thikë i ndjeri. Atëherë si është e mundur gjykata të vjen në asi përfundimi se të ndjerin e ka goditur edhe Sh. K. por thikën e ka fshehur.

Për më tepër, Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit konstaton gjendjen se sipas dëshmive të dëshmitarit M. H. i ndjeri kishte pas konflikte të mëhershme me të akuzuarin dhe vëllain e tij dhe sipas gjykatës ky ishte motivi për kryerjen e kësaj veprë. Si është e mundur që gjykata ka konstatuar këtë motiv kur as edhe një provë e vetme nuk është në këtë drejtim. Të njëjtën gjë e kanë mohuar edhe babai i tani të ndjerit, e ka mohuar daja i të ndjerit i cili ishte edhe dëshmitar i ngjarjes, e ka mohuar dëshmitari G., e ka mohuar vet i akuzuari, ndërsa e ka dëgjuar M. por as nuk dinë kur dhe nga kush e ka dëgjuar.

Gjithashtu, gjykata e ka marr edhe dashjen direkte dhe vullnetin e madh të të akuzuarit për të kryer këtë veprë, mirëpo askund nuk e vlerëson faktin se i akuzuari Sh. po të kishte dashtë ta ngacmonte tani të ndjerin ai ka mundur ta fillojë këtë në autobus apo pasi kanë zbritur apo edhe diku tjetër. Sipas dëshmitarëve G. dhe M. dhe K. (dajës së të ndjerit) konfliktin e ka filluar tani i ndjeri duke e fyer një të mitur dhe duke e goditur me grusht dhe shkelm dhe vetëm pastaj i akuzuari Sh. ka vrapuar tek vëllai i tij dhe ka bërë turrë ik se kam thikë. Këtë e ka deklaruar dëshmitari M.. E pastaj është ndalur por i ndjeri duke menduar se do ti sulmojnë dajën kthehet

dhe e sulmon të akuzuarin Sh. dhe e godet me grusht dhe aty fillon edhe përleshja në mes të të ndjerit dhe të akuzuarit. Sikur ta kishin dashur kryerjen e veprës pse atëherë e paralajmëroi me fjalët "ik se kam thikë", pse nuk e sulmoj askund më herët dhe pse nuk e preku fare dëshmitarin K.. Andaj, kjo tregon se duke u ballafaquar me një situatë të pa provokuar nga i njëjti dhe duke e parë se kanë të bëjnë me një person sportist kampion në Kosovë në kategorinë e tij është dashur që të nxjerr thikën për ta mbrojtur vëllain e tij e jo privuar nga jeta tani të ndjerin.

Gjithashtu, Gjykata e shkallës së parë konstaton se vepra penale është kryer në bashkëkryerje, mirëpo në asnjë rast nuk e elaboron bashkëkryerjen se si u manifestua bashkëkryerja, siç përcaktohet me dispozitën e nenit 31 të KPPK-së. E krejt kjo kur tanimë kemi aktgjykim të formës së prerë lidhur me veprën penale të Vrasjes ku është gjykuar dhe gjetur fajtor i mituri A.K.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, mbrojtja pretendon se dënimi i shqiptuar është tepër i lartë krahasuar me rrethanat që do të duhej të aplikoheshin në rastin e matjes së vendimit mbi dënimin. Rrethanat lehtësuese nuk u vlerësuan si duhet, ngase gjykata mori parasysh faktin se i njëjti i ka kërkuar falje, moshën e tij re dhe nuk ka të kaluar kriminale dhe prap i shqiptoi dënim unik 20 vite. Andaj, si mund të vlerësoj gjykata që i njëjti sapo ka mbushur 18 vite dhe nuk ka të kaluar kriminale, prapë t'i shqiptoj një dënim që ndoshta është i vetmi i kësaj lartësie në Gjykatat e Kosovës edhe për madhor e leje më për një të mitur të rritur i cili sapo i ka mbushur 18 vite. Ndërsa si rrethanë rënduese e merr dashjen direkte dhe dëshirën e tij për ta kryer vrasjen. Po si është e mundur që gjykata të këtë konstatuar se i njëjti paska pas dashje direkte dhe aq shumë e paska dashtë vrasjen kur i njëjti as që e ka filluar ngjarjen, as që ka qenë prezent kur ka filluar ngjarja e kur një madhor me profesion boksier dhe atë kampion në kategorinë e tij, siç thotë edhe babai i të njëjtit po ja rrihte vëllain e mitur, e i akuzuari kishte bërëtitur ik se kam thikë dhe i njëjti pasi kishte ikur, ishte kthyer të rrahej me të akuzuarin Sh., prej nga atëherë gjykata konstaton se kishte pasur dëshirë të madhe të ja marr jetën tani të ndjerit. Pra edhe këtu gjykata nuk ka zbatuar në mënyrë të duhur dispozitat që kanë të bëjnë me "zbatimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese".

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, e duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i ankimuar duhet anuluar ngase i njëjti është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.10, lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 KPPRK.

Pretendimet e mbrojtjes për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në marrjen e vendimit gjyqësor të drejtë dhe të ligjshëm, kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se janë të bazuara, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar komformenit 369 par.6 dhe 7 lidhur me nenin 364 të KPPRK-së, nuk janë paraqitur shkaqet dhe arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të paprovuara duke mos dhënë vlerësimin e provave, ndërsa ato që janë dhënë, nuk janë në pajtueshmëri të plotë me provat dhe shkresat e lëndës, andaj aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që kanë kushtëzuar anulimin dhe kthimin e çështjes në rivendosje.

Nga përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit për të akuzuarin Sh. K., i shpallur fajtor në bashkëkryerje me të miturin A.K., kolegji i gjykatës së apelit vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë i pakuptueshëm dhe si i tillë është i mangët dhe në kundërshtim me arsyetimin e tij, ngase gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka dështuar që të përshkruajë në dispozitivin faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, e që kjo mungesë e konstatimeve të theksuara e bën aktgjykimin e pa qartë, andaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.7 lidhur me nenin 369 të KPPRK-së. Aktgjykimi i nxjerrë, duhet të jetë i kuptueshëm, i qartë dhe në harmoni me vetveten dhe pjesët tjera të aktgjykimit, për tu dhënë arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit.

Nga konstatimi në aktgjykimin e shkallës së parë dhe nga të gjitha shkresat e lëndës del se është i pakontestueshëm fakti se me datën 10.12.2021, rreth orës 21:25 në rrugën T. L., në fshatin H., derisa i mituri A.K (tani i dënuar me aktgjykimi të formës së prerë) ishte në shoqëri me shokët e tij M. H. dhe G. S., aty kishte kaluar tani i ndjeri V. Xh. së bashku me dajën e tij K. P., të cilët sapo kishin zbritur nga autobusi në të cilin kishte udhëtuar edhe i akuzuari Sh. K., dhe aty posa ishin afruar afër të miturit, kishte filluar një fjalosje mes të miturit A.K dhe tani të ndjerit V., fillimisht me sharje, nga ana e të ndjerit dhe pastaj edhe një përleshje mes tyre, ku kishte ndërhyrë edhe i akuzuari Sh. dhe së bashku me të miturin e godasin me thika tani të ndjerin, gjithsej 4 plagë, ku vetëm njëra plagë ishte vdekjeprurëse, sipas konstatimit nga eksperti mjeko ligjor.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se dy të akuzuarit kishin thika, fakt i vërtetuar nga të gjithë dëshmitarët e dëgjuar para gjykatës por edhe në deklaratimet e tyre të mëparshme, këtë e ka pranuar edhe vet i akuzuari Sh. K., derisa për këtë rrethanë eksperti mjeko ligjor kishte dhënë dy mendime si në vijim: ” se bazuar nga plagët nuk mund të themi me besueshmëri të lartë se a kanë

qenë një thikë apo dy thika, nuk e mohojmë as njërën e as tjetrën se plagët janë të shkapërderdhura”.

Ndërsa sipas mendimit plotësues nga eksperti, pas rikonstruimit të vendit të ngjarjes, se “Mjeti i prezantuar në vendin e ngjarjes – i metalit (thikë –brisk), “një thikë me gjatësi 6 cm, me mbishkrim “Leatherman Sidekick” e sekuestruar nga i akuzuari Sh. K. pas arrestimit afër shtëpisë së tij”, nuk është mjeti i cili ka shkaktuar plagët në trupin e të ndjerit – mjeti i cili ka mundur të shkaktoj dëmtimet e përshkruara në raport – duhet të jetë me gjatësi dhe gjerësi më të madhe të tehut të tij, meqë dëmtimet i ka majtas (në krah), në pjesën e përparme (në abdomen) nën sjetullën e djathtë si dhe në dorë e djathtë *nuk e përjashtoj mundësinë të kenë qenë të përdorura 2 mjete që kanë maje dhe teh* - plaga në dorë dhe nën sjetullën e djathtë janë të njëjta dhe kanë përmasat rreth 20 mm – kurse dy plagët e tjera janë më të mëdha dhe më të thella (ajo në krah dhe në abdomen).

Kolegji i gjykatës së Apelit, lidhur me pretendimin e mbrojtësit sa i përket mendimit të ekspertit mjeko ligjor të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të të miturit, se plagët e shkaktuara tek i ndjeri në krah dhe parakrah janë të shkaktuara nga mjeti që posedon dy tehe, vlerëson se kane ngelur mëdyshje dhe fakte të pavërtetuara nëse i akuzuari e kishte përdorur këtë mjet në formë thike – danave, e cila ishte sekuestruar nga i akuzuari me rastin e arrestimit të tij dhe dy plagët ia kishte shkaktuar tani të ndjerit sipas ekspertit mjeko ligjor, e që rrjedhimisht lidhur me përdorimin e kësaj arme i akuzuari ishte deklaruar fajtor me pranimin e fajësisë në seancën e shqyrtimit fillestar, se vdekja e tani të ndjerit ishte kryer me këtë mjet të përdorur nga i akuzuari në bashkëkryerje me të miturin.

Kolegji gjen se aktgjykimi është kundërthënës në pjesën e arsyetimit në faqen 17 në rreshtin e fundit dhe në fillim të faqes 18, ku konstaton “Gjykata nuk ka mundur ta vërteton faktin se cili nga të pandehurit e kishte dhënë goditjen fatale duke goditur mëlçinë e të ndjerit me thikë që ishte shkaktar i vdekjes por bazuar nga deklarimi i ekspertit dhe deklaratat e dëshmitarëve është vërtetuar fakti se që të dytë të pandehurit e kanë goditur me thikë të ndjerin me çka janë konstituar veprimet e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje.

Po ashtu në faqen 20 të arsyetimit gjykata konstaton “ Për më tepër, nga provat e administruara vërtetohet fakti se i pandehuri ishte i pajisur me armë të ftohtë thikë dhe nga raporti i obduksionit shihet se viktimja kishte marrë shumë plagë konkretisht therrje me thikë dhe të gjithat në pjesën e epërme të trupit, kjo tregon se i pandehuri kishte përzgjedhur vendin më të përshtatshëm për

shkaktimin e pasojës pra, për ta privuar nga jeta të ndjerin”, pjesë kjo e arsytimit që bie në kundërshtim me pjesën e elaboruar më lart.

Kolegji kujton se lidhur me këtë fakt tepër të rëndësishëm dhe vendimtar janë dhënë konstatime kundërthënëse, se nuk dihet se cili nga të akuzuarit i kishte shkaktuar plagën vdekjeprurëse, derisa në pjesën tjetër konstaton se i akuzuari Sh. me thikë kishte përzgjedhur vendin me të përshtatshëm për shkaktimin e pasojës për ta privuar nga jeta.

Gjithashtu një kontradiktë shumë e rëndësishme sa i përket armës ku gjykata në arsytimin të aktgjykimit në faqen 21 ka theksuar “se në rikonstruksion të vendit të ngjarjes kur i është prezantuar thika dëshmitarit K. P., thika të cilën e ka dorëzuar Sh. K., i njëjti thotë :”*Jo, këtë thikë nuk e ka përdorur i mituri A.K., por një thikë tjetër që ka pasur teq më të madh sepse kur e ka nxjerrë nga xhepi nuk ka pasur nevojë që të hapet*”. Pra thika e dorëzuar nga i akuzuari, dëshmitari sqaron se kjo nuk është thika e përdorur nga i mituri, që përsëri len mëdyshje në vërtetësinë e fakteve dhe rrethanave.

Lidhur me pretendimin e mbrojtësit se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas përshkrimit të dispozitivit të aktit akuzues se me armën thikën me gjatësi 6 cm, me mbishkrim “Leatherman Sidekick, e ka kryer veprën penale, e sipas ekspertit pas rikonstruimit del se ajo nuk është thika e përdorur, kolegji gjen se janë pretendime të bazuara, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se aktakuza të akuzuarin Sh. K. e ngarkonte për veprën, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, se “Në vendin, kohën dhe ditën e njëjtë si në dispozitivin I të kësaj aktakuze, i pandehuri Sh. K. në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armë, ka mbajtur në pronësi armë, përkatësisht një thikë me gjatësi 6 cm, me mbishkrim “Leatherman Sidekick” të cilën e ka përdorur për ta kryer veprën penale si në dispozitivin e I të aktakuzës dhe të cilën policia e kanë gjetur dhe sekuestruar nga i pandehuri Sh. K. gjatë arrestimit të tij”.

Kolegji gjen se, i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 16.01.2023, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av Florent Latifaj ishte deklaruar fajtor për këtë veprë penale pikërisht me përshkrimin sikurse në aktin akuzues dhe pas marrjes së mendimit edhe nga prokuroria, pala e dëmtuar dhe mbrojtësi, gjykata e kishte aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, se ishte pranim i vullnetshëm dhe ishte në përputhshmëri me shkresat e lëndës, e cila përputhshmëri ishte derisa eksperti mjeko ligjor kishte deklaruar se ky nuk është mjeti me të cilën i ishin shkaktuar plagët të ndjerit, ngase mjeti i cili ka mundur ti shkaktoj dëmtimet e

përshkruara në raport duhet të jetë me gjatësi dhe gjerësi më të madhe të tehut, duke mos e përjashtuar mundësinë të jenë përdorur 2 mjete që kanë maje dhe teh.

Kolegji gjen se, përkundër deklaramit të ekspertit mjeko ligjor që kishte mospërputhshmëri me mjetin – thikën e përdorur me atë të prezantuar, prokuroria në fjalën përfundimtare të përshkruar edhe në aktgjykim në faqen 4, kishte mbetur pranë aktit akuzues, për faktin se i akuzuari për veprën penale nën pikën II e kishte pranuar fajësinë duke e konsideruar si të vërtetuar dhe nuk është lëshuar më shumë në argumentimin e saj, por vetëm për veprën penale për pikën I, ndërsa gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka bërë një përshkrim në dispozitiv,

si në vijim: “Në vendin, kohën dhe ditën e njëjtë si në dispozitivin I të kësaj aktakuze, i pandehuri Sh. K. në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armë, ka mbajtur në pronësi armë, përkatësisht një thikë me gjatësi 6 cm, me mbishkrim “Leatherman Sidekick” të cilën policia e kanë gjetur dhe sekuestruar nga i pandehuri Sh. K. pas arrestimit afër shtëpisë së tij, ku gjykata në arsyetimin e aktgjykimit në faqen 24 për këtë çështje ka theksuar “gjykata e kishte parasysh faktin se kishte bërë pranimin e fajësisë në seancën e shqyrtimit fillestar për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe objekt i shqyrtimit gjyqësor nuk ishte kjo pikë e aktakuzës, por pas administrimit të provave në këtë çështje penale e sidomos deklaramit të ekspertit mjeko ligjor dhe plotësimit të ekspertizës mjeko ligjore pas rikonstruksionit të vendit të ngjarjes kishte konstatuar se mjete i prezantuar në vendin e ngjarjes - i metalit, (thike-brisk) i gjetur tek i pandehuri Sh. nuk është mjete i cili ka shkaktuar plagët në trupin e të ndjerit dhe mjete i cili ka mundur ti shkaktoj dëmtimet e përshkruara në raport - duhet të jetë me gjatësi dhe gjerësi më të madhe të tehut të tij. Bazuar në këtë konstatim të ekspertit Gjykata bëri ndryshimin e përshkrimit faktik *duke fshirë pjesën e dispozitivit ku thuhet me të cilën thikë i pandehuri kreu vrasjen*, ky ndryshim nuk ndryshon kualifikimin juridik por e përshtat gjendjen e vërtetuar faktike nga administrimi i provave të bëra në këtë shqyrtim gjyqësor, kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë vepër penale me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit është dashur që ta ri konsideron çështjen e pranimin të fajësisë ngase kishte vërtetuar një tjetër gjendje faktike (...se a kishte pranuar fajësi me ndryshim të gjendjes faktike), përkundër asaj se kualifikimi mbetet i njëjti sipas arsyetimit të gjykatës, ngase ky pranim tani më nuk është në përputhshmëri me provat dhe shkresat e lëndës ngase gjykata kishte nxjerr një aktvendim që e kishte pranuar një gjendje tjetër faktike, kurse pranimi i fajësisë komformenit 242 par. 2 nënpar.2.3 të KPRK-së, përcakton se pranimi fajësisë mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës së pranuar nga i akuzuari dhe *çdo provë tjetër...., e jo ti hiqen fjalët nga përshkrimi*

faktik, duke e ndryshuar gjendjen faktike, përkundër se kualifikimi përsëri mbetet i njëjti sikurse ka vepruar gjykata e shkallës së parë.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se mjeti i sekuestruar me rastin e arrestimit të të akuzuarit, Leatherman Sidekick së bashku edhe me shumë dëshmitë e tjera të gjetura nga vendi i ngjarjes ishin dërguar për ekspertizë në Agjensionin e Forenzikës, por në mungesë të arsyetimit lidhur me këtë raport në aktgjykim, lëne të pasqaruar faktin nëse është bërë ekzaminimi i saj apo jo.

Kolegji vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar edhe në vërtetimin e gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, e që të dy këto shkelje kanë ndikuar në shkeljen e ligjit penal, nga se pa eliminimin e shkeljeve në fjalë nuk mund të flitet për vërtetim të gjendjes faktike e as aplikim të drejtë të ligjit penal, për çka kolegji i apelit vendosi që çështja në fjalë të anulohet dhe të kthehet në rigjykim.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë, duhet të veprojë në harmoni me vërejtjet e cekura si më lartë, ti eliminoj shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të procedojë edhe njëherë me të gjitha provat dhe të bëjë vlerësimin e tyre, të vlerësohet mendimi i ekspertit mjeko ligjor, apo për sqarimin e fakteve të ftohet edhe një herë, të sigurohet raporti nga Agjencia e Forenzikës lidhur me ekzaminim e mjetit të sekuestruar nga i akuzuari “Leatherman Sidekick, në rast se nuk është bërë, e sipas rrjedhës së procedurës të nxjerrën edhe prova të tjera të cilat janë me rëndësi për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, të jepen arsye edhe për faktet vendimtare dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerrë konkluzione të drejta dhe të ligjshme që vërtetojnë drejt gjendjen faktike.

Po ashtu sa i përket veprës penale nën dispozitivin e dytë të aktgjykimit, pas eliminimit të të gjitha dilemave, nëse rezulton se i akuzuari nuk e ka përdorur thikën- mjetin e sekuestruar në kryerjen e veprës penale, të vlerësoj se a ekziston kjo vepër penale, se mbajtja e mjetit të tillë a konsiderohet armë apo a është mjet që hyn në kategorinë e armëve.

Pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat janë vlerësuar sipas detyrës zyrtare, ankesa e Prokurorisë Themelore, nuk është shqyrtuar, e njëjta është jo lëndore pasi që çështja penale është anuluar dhe i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Ndaj të akuzuarit gjykata vendosi ti vazhdohet masa e paraburgimit pasi që vlerësoj se edhe më tutje ekzistojnë bazat ligjore mbi bazën e të cilave i është caktuar dhe më pas vazhduar paraburgimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 402 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PAKR.nr.614/24

Datë: 05.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Jeta Asllani

Valbona Musliu Selimaj

Mentor Bajraktari

Kymete Kicaj